VENDIM
Nr.142, datë 23.2.2011

PËR MIRATIMIN E "PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE" DHE TË DOKUMENTIT PLOTËSUES "PLANI I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE, VIKTIMA TË TRAFIKIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e "Planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore" dhe të dokumentit plotësues "Plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit", sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministritë, si dhe institucionet e tjera qendrore e vendore, të përmendura në tekstin e këtyre planeve të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për monitorimin e zbatimit të këtyre planeve të veprimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha